



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, vvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 15. 22, dhe 24 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 dhe nenit 11. par. 1. pika 2. të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, nenit 1. dhe 2. të U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04.mars/2004, nenit 38.pika1.2, 1.3. dhe 1.4. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në mbështetje të pikës IV, V, dhe VI. të Vendimit të KK-ës Gjilan, nr. 01-11735, dt. 30.10.2008, për miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më: 17.07. 2013, miraton këtë:

V E N D I M I

Për miratimin e kushteve të përkohëshme Urbanistiko-Arqitektonike dhe Kushteve të Ndërtimit për disa pjesë të përfshira e Planin Zhvillimor Urban të "Qytetit të Gjilanit"

I.

Me këtë Vendim, miratohen kushtet e përkohëshme urbanistiko-arqitektonike dhe kushtet e ndërtimit për disa pjesë të Planit Zhvillimor Urban të "Qytetit të Gjilanit", (në tekstin e mëtejshëm: Kushtet Urbanistike) i cili përfshinë parcelat të cilat drejtëpërdrejtë tangjentojnë me rrugët kryesore në pjesë të ndryshme të Qytetit të Gjilanit, e për të cilat nuk janë miratuar Planet e reja Rregulluese Urbane ose këto plane janë në proces të revidimit.

II.

Rrugët kryesore dhe parcelat, sipas pikës I. të këtij Vendimi, përfshijnë hapësirat e shënjëzuara dhe të përkufizuara dhe atë: Rrugët: 1. "Ali Hadri", 2. "Idriz Seferi", 3. "Isa Boletini"; 4. "Xhemajl Mustafa", "Bulevardi i Pavarsisë"; 5. "Lidhja e Prizrenit"; 6. "Qershor 99"; 7. "Medlin Ollbrajt"; 8. "Nëna Terezë"; 9. "Pajazit Ahmeti"; 10. "Halim Orana"; 11. "Haki Myderrizi"; 12. "Haqif Tetova"; 13. "Muhagjerët"; 14. "Gjon Sereqi"; 15. "Eleaz Agushi"; 16. "Isa Boletini"; 17. "Xhevat Ajvazi"; 18. "Urim Mehmeti"; 19. "Komandant Drini"; 20. "Sadulla Brsetovci"; dhe 21 "Esat Berisha" në tërësi sipas paraqitjes grafike në ortofoto, me parametra të profilimit të rrugëve dhe kriterëve urbanistike, e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

III.

Kushtet e përkohëshme urbanistike nga pika I. e këtij Vendimi, i referohen kushteve, kriterëve dhe përmbajtjeve të përcaktuara me PZHU: "Qyteti i Gjilanit" dhe PRU: "Qendra-z/1", në tërësi sipas parametrave të paraqitur në pasyrën tabelare për sejcilin profil veq e veq, e cila është pjesë përbërse e këtij vendimi.

IV.

Kushtet e përkohëshme urbanistike nga pika I. e këtij Vendimi janë përpunuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit dhe përbëjnë dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit, organizimit dhe destinimit të hapësirës së këtyre lokacioneve, përcakton rregullat dhe kriteret e ndërtimit të objekteve banimore-afariste dhe rrjetit të objekteve të Infrastrukturës teknike komunale.

V.

Kushtet e përkohëshme Urbanistike sipas këtij vendimi do të aplikohen për të gjitha parcelat që kanë qasje të drejtëpërdrejtë me rrugët e paraqitura grafiki në pikën II. të këtij vendimi, si dhe parcelat tjera me të cilat mund të krijohet një parcelë-tërësi më e madhe duke iu bashkangjitur parcelës që ka qasje të drejtëpërdrejtë në rrugën kryesore.

VI.

Kushte e përkohëshme urbanistike nga ky vendim, duhet të inkorporohen në Planet e ardhshme Rregulluese Urbane të lokacionive përkatëse, me rastin e hartimit dhe miratimit të këtyre Planeve.

VII.

Parcelat e përfshira me këtë Vendim, të cilat janë të destinuara për hapësira dhe objekte publike të infrastrukturës teknike komunale, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me Interes të Përgjithshëm Publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

VIII.

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, përmes Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtorisë për Shërbime Publike të KK-ës Gjilan.

IX.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushojnë të vlejshme pjesët e Planeve Detaje Urbanistike (të vjetra), apo akteve tjera të cilat i kanë zavendësuar ato plane, për pjesët e përfshira me këtë Vendim.

X.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ëeb faqen e Komunës.

A r s y e t i m

i Propozim Vendimit për miratimin e kushteve të përkohëshme urbanistiko-arqitektonike dhe kushteve të ndërtimit për disa pjesë të përfshira me Planin Zhvillimor Urban të "Qytetit të Gjilanit"

Bazë juridike për miratimin e Vendimit për miratimin e kushteve të përkohëshme urbanistiko-arqitektonike dhe kushteve të ndërtimit për disa pjesë të përfshira me PZHU "Qyteti i Gjilanit", janë dispozitat e neit 15. 22, dhe 24 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.14/ 2003 dhe nenit 11. par. 1. pika 2. të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, dispozitat e Statutit të Komunës së Gjilanit, Vendimi i KK-ës Gjilan për miratimin e Planit Zhvillimor Urban, nr. 01.11735, dt. 30.10 2008 dhe Vendimi nr. 01.5791 të dt. 19.05.2010, për miratimin e PRrU: "Qendra-z-1" si dhe nevoja e unifikimit të kushteve dhe kriterëve të ndërtimit për zonat e caktuara të cilat drejtëpërdrejtë tangjentojnë me rrugët kryesore brenda zonës së vjetër të Qytetit.

Për shkak të Planeve të vjetra urbanistike në pjesën e vjetër të Qytetit të Gjilanit dhe disa pjesëve për rreth, disa prej të cilave datojnë që nga viti 1973, 1980 dhe 1984 dhe më vonë dhe e të cilat janë të tejkaluara dhe nuk përkojnë me konceptet e reja zhvillimore dhe destinimet e parapara me Planin Zhvillimor Urban të miratuar në vitin 2008, e me qëllim të përshtatjes së këtyre kushteve me PZHU deri në miratimin e Planeve të reja, krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm dhe bashkohor, krijimin e kushteve dhe mundësive për rregullimin dhe shfrytëzimin racional të tokës ndërtimore, hapësirës publike, profilimit të rrugëve, lehtësimit të lëvizshmërisë të qytetarëve dhe pjesëmarrsëve tjerë në komunikacion, krijimin e kushteve dhe mundësive për kyqje dhe qasje të lira në objektet e infrastrukturës teknike komunale, rrugë, trotoare, parkingje, hapësira të gjelbërta, shtigje, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit, rrejtin e përvojave dhe instalimeve elektroenergjetike dhe telekomunikuese si dhe krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm e bashkohor.

Miratimi i Vendimit të lartëpërmenudur, poashtu krijon bazë juridike të qëndrueshme për trajtimin shumë më të përshtetshëm të kërkesave të qytetarëve dhe investuesve potencial, e që vë mënyrë direkte krijon mundësi të rritjes së të hyrave financiare të komunës.

Këto kushte do të jenë të karakterit të përkohshëm deri me rastin e hartimit dhe miratimit të Planeve të reja Rregulluese Urbane të lokacionive përkatëse, me mundësi të inkorporimit të tyre në Plane të reja.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit

Gjilan, Shkurt/2013.